

## Merdede (Vesel) Morina

(1994, shqiptare nga Senoci/Sanovac, komuna e Rahovecit/Orahovac)

Afro 200 banorë të Sanocit/Sanovac e braktisën fshatin më 3.09.1998. U strehuan në pyjet e fshatit **Pastasellë/Pusto Selo**. Por, forcat serbe i zbuluan shpejt dhe, në mëngjesin e datës **4.09.1998**, ato iu afruan të zhvendosurve shqiptarë. Shumë prej të zhvendosurve u tërhoqën më thellë në pyjet, ndërkaq prindërit e Merdetes, familjet me fëmijë dhe persona të moshuar ndenjën aty ku ishin. Rreth orës 15:00, pranë tyre erdhi një grup ushtarësh serb nga drejtimi i fshatit Zatriq/Zatrici. Ata pa kurrfarë paralajmërimi dhe nga distanca e vogël hapën zjarr drejt të zhvendosurve të mbetur. Merdeden në ato çaste i ati Veseli e mbante ngrykë. Merdetja, pesë vjeçe, u qëllua me 15 plumba, ndërkaq i ati Veseli vetëm u plagos. Po atë ditë, por më vonë, forcat serbe u lejuan prindërve që ta varrosnin Merdeden në pyll. Tri ditë më vonë, kur forcat serbe u tërhoqën nga rajoni, familjarët e kanë rivarrosur Merdeden në varrezat në Senoc/Sanovac.

**Burimi:** deklarata V.M, FDH-17950.

## Haki (Avdi) Hoti

(1933, shqiptar nga Ratkoci/Ratkovac, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, dhjetë fëmijë)

Në datën **4.09.1998**, kur forcat serbe e bombarduan **Ratkocin/Ratkovac**, një predhë e ka qëlluar Hakiun, i cili rastisi të ishte në rrugë, afër shtëpisë së vet. Hakiun e varrosën në varrezat e Ratkocit/Ratkovac, më 9.09.1998.

**Burimi:** deklarata B.H, FDH-14558.

## Refki (Mehmet) Spahiu

(1.05.1984, shqiptar nga Drenoci/Drenovac, komuna e Rahovecit/Orahovac, i pamartuar)

Popullata e Drenocit/Drenovac u zhvendos në pyjet më 3.09.1998, kur forcat serbe e nisën ofensivën kundër forcave të UÇK-së, që e kishin postin komandues në këtë fshat. Familja e Refkiut u nis me traktor me rimorkio. U strehuan në pyllin e lagjes *Babovc/Bobovac* [**Bratotin**]. Traktorin dhe

rimorkion i kanë skajuar prapa një shkurre të madhe. Forcat serbe ishin të stacionuara në fshatin Pastasellë/Pusto selo dhe herë pas herë shtëninë në drejtim të refugjatëve. Në mbrëmje, më **4.09.1998**, në çastin kur Refkiu hipi në rimorkion e traktorit, një plumb e ka qëlluar në gjoks. Ka ndërruar jetë në të njëjtën mbrëmje nga plaga. Një ditë më vonë, prindërit e kanë varrosur në varrezat e lagjes *Babovc/Bobovac*.

**Burimet:** deklarata M.S, FDH-40581; J. Osmani, *Krimet...*, II, 249.

## Qazime (Hasan Gashi)

### Bajraktari

(10.11.1934, shqiptare nga Polluzhë/Poluža, komuna e Rahovecit/Orahovac, amvise, shtatë fëmijë)

Kur forcat serbe e sulmuan **Polluzhën/Poluža** më 4.09.1998, Qazimja me të birin, familjen e tij dhe banorë të tjerë u strehuan në pyll pranë fshatit. Ditën tjetër, më **5.09.1998**, rreth orës 15:00, forcat serbe filluan t'i afroreshin pyllit. Të kapluar me panik, banorët nisën të vraponin dhe të shpërndareshin në të gjitha drejtimet dhe në thellësi të pyllit. E sëmur dhe gati e palëvizshme, Qazimja nuk arriti të largohej. Disa orë më vonë, i biri u kthye në vendin ku e kishte lënë të ëmën dhe e gjeti trupin e saj të pajetë. Në të njëjtën mbrëmje, ai e varrosi Qazimen në të njëjtin vend ku e kishte gjetur të vdekur. Pas përfundimit të luftës, në muajin korrik të vitit 1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Qazimes në varrezat e Polluzhës/Poluža.

**Burimet:** deklarata H.U, FDH-15497; *Serb Forces Kill at Least 11 Albanians in Two Villages of Rahovec Friday*, pasqyra e lajmeve, KIC, 06.09.1998, FDH-29552.

## Afrim (Xhavit) Bajraktari

(18.06.1971, shqiptar nga Polluzhë/Poluža, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor ndërtime, dy fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Afrimi dhe i vëllai Lulzimi u bënë pjesëtarë të UÇK-së, pas sulmit të forcave serbe mbi fshatin fqinj të Saroshit/Saroš [12.05.1998]. Kur, më 4.09.1998, forcat serbe e sulmuan